

**SUPREME COURT OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**  
**KOLEGJI I APELIT TË AKP-së**  
**ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-107/15

Prishtinë,  
22 Mars 2017

Në çështjen juridike të

**M. K.**

Prizren

**Pala ankuese**

kundër

**M. G.**

Beograd

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit i AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/240/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA14007) të datës 30 prill 2014, pas shqyrtimit të mbajtur në 22 mars 2017, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M. K. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/240/2014 të datës 30 prill 2014 sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA14007.
2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/240/2014 i datës 30 prill 2014, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA14007.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 28 korrik 2006, M. G. (më tutje: pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (më tutje: AKP). Kërkesën e kishte paraqitur në emër të nënës së tij të ndjerë, V. G., duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr. 3331, objekt afarist me sipërfaqe prej 22 m<sup>2</sup>, që gjendej në rrugën "M.Tito nr.10", Komuna e Prizrenit (më tutje: pronare e kërkuar). Ai pretendoi se nëna e tij është pronare e pronës së kërkuar e cila është uzurpuar nga familja K.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala përgjegjëse në ankesë i dorëzoi në AKP këto prova:
  - Fletën Poseduese nr.3367 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë të Komunës së Prizrenit, ku pronat e kërkuara janë të regjistruara në emër të V. G.
  - Çertifikata e vdekjes nr.2481/1982 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës së Prizrenit më 3 dhjetor 2004 që tregon se V. G.C. ka vdekur më 4 maj 1982 në Prizren.
  - Çertifikata e lindjes nr.116/1930 e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës së Prizrenit më 7 prill 2005 që e dëshmon lidhjen familjare ndërmjet palës përgjegjëse në ankesë dhe V. G.
  - Padi e paraqitur nga M., S. dhe M. G. kundër Gj. dhe K. K. pranë Gjykatës së Beogradit në vitin 2006. Paditësit kërkonin lirimin e pronës dhe kompensim për pasurim të paligjshëm.

3. Më 27 mars 2008, AKP-ja e identifikoi pronën e kërkuar. Prona u gjet të jetë një dyqan i uzurpuar nga L.K. (më tutje: pala ankuese) i cili pretendoi se e kishte lejen nga pronari i ligjshëm për ta uzurpuar pronën; megjithatë, ai qëndroi pasivë gjatë tërë procedurës para AKP-së.
4. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e verifikoi pozitivisht Fletën Poseduese nr.3367 dhe provat tjera të dorëzuara nga pala përgjegjëse në ankesë.
5. Përpjekja e Sekretarisë Ekzekutive për ta informuar palën ankuese rreth gjetjeve dhe për ta këshilluar që ai të dorëzojë prova në mbështetje të pretendimit të tij dështoi sepse përfaqësuesi i tij ligjor deklaroi se pala ankuese është në burg, ndërsa xhaxhai i palës ankuese (M.K.) është në posedim të tanishëm të pronës së kërkuar (faqe 066 të shkresave të lëndës).
6. Më 30 prill 2014, KKPK-ja me Vendimin e vet KPCC/D/C/240/2014 vendosi se pala përgjegjëse në ankesë e kishte vërtetuar të drejtën e pronësisë të V. G. mbi pronën e kërkuar dhe vendosi që pronën e kërkuar ta kthejë në posedim të palës përgjegjëse në ankesë.
7. Më 30 mars 2014, Vendimi iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë.
8. Pala ankuese e pranoi Vendimin më 8 shtator 2014. Ankesa u ushtrua më 7 tetor 2014.

### **Pretendimet e palës ankuese**

9. Pala ankuese pretendon se Vendimi i KKPK-së përmban shkelje thelbësore të së drejtës materiale dhe procedurale si dhe vërtetim të gabuar dhe të mangët të gjendjes faktike.
10. Pala ankuese deklaroi se pala përgjegjëse në ankesë ia kishte shitur pronën e kërkuar Gj. dhe K. K. për çmimin e blerjes prej 120.000 DM. Kjo shumë e parave i është dërguar palës përgjegjëse në ankesë. Kontrata e Shitblerjes është lidhur më 20 maj 1991. Sipas palës ankuese, pala përgjegjëse në ankesë pranoi se prona e kërkuar është e regjistruar në emër të nënës së tij të ndjerë, V. G. Prandaj, Kontrata e Shitblerjes ishte lidhur vetëm për ta siguruar transferimin e të drejtës së pronësisë në emër të blerësit pasi të jetë kryer procedura e trashëgimisë.
11. Pala ankuese ankesës ia bashkëngjiti këto dokumente:
  - Kontratën e Shitblerjes të lidhur më 25 dhjetor 1998 ndërmjet M. G. si shitës dhe K. K. si blerës i pronës së kërkuar. Kontrata nuk është e legalizuar.
  - Deklaratën me shkrim, të vërtetuar me numrin 6381/2006 para Gjykatës Komonale të Prizrenit më 27 nëntor 2016, në të cilën H. R. deklaroi se ai ka qenë i pranishëm kur K. K. e kishte blerë pronën e kërkuar nga pala përgjegjëse në ankesë.

- Deklaratën me shkrim, të vërtetuar me numrin 6380/2006 para Gjykatës Komunale të Prizrenit më 27 nëntor 2016, në të cilën K. K. deklaroi se e kishte blerë pronën e kërkuar nga pala përgjegjëse në ankesë më 25 dhjetor 1998.

### Arsyetimi ligjor

#### *Pranueshmëria e ankesës*

12. Gjykata Supreme e shqyrtoi Vendimin ankimor në përputhje me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr.03/L-006 (më tutje: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese konstatoi se:  
Ankesa është e pranueshme sepse është ushtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 që parasheh se pala mund të paraqes ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e njoftimit të palëve për Vendimin.

#### *Meritat e ankesës*

13. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, Gjykata Supreme vëren se ankesa është e pabazuar.
14. Vendimi i KKPK-së është korrekt. Gjykata nuk ka mundur të konstatojë as vërtetim të mangët ose të gabuar të fakteve e as zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.
15. Në përputhje me nenin 3.1 të Ligjit nr.03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga Komisioni për ri-posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm të drejtën e pronësisë mbi pronën e paluajtshme private, por edhe se ai apo jo nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo burojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
16. Gjykata Supreme vëren se pala ankuese, ndonëse ka pretenduar të drejtë ligjore mbi pronën, ka dështuar që të paraqet ndonjë dokumentacion apo informatë tjetër për ta mbështetur të drejtën e pretenduar si në kohën kur është identifikuar prona e ai ishte prezent gjatë procesit të identifikimit ashtu edhe gjatë procedurës para shkallës së parë, edhe pse atij i është dhënë mundësia që ta bëjë këtë.
17. Pala Ankuese ka reaguar vetëm gjatë stadiit ankimor të procesit gjyqësorë duke bashkangjitur si dokument Kontratën e Shitblerjes e cila nuk ishte e legalizuar.

18. Në bazë të nenit 12.11 të Ligjit 03/L-079, faktet dhe provat materiale të reja të paraqitura nga cilado palë në ankesë nuk pranohen dhe shqyrtohen nga Gjykata Supreme përveç nëse demonstron se ato fakte dhe prova nuk kanë mundur të dihen në mënyrë të arsyeshme nga pala përkatëse.
19. Gjendja faktike në lidhje me këtë çështje juridike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht dhe Vendimi i KKPK-së nuk është kontestuar me ndonjë provë të vlefshme.
20. Në bazë të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur sikurse në dispozitiv.

### **Këshillë ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Beshir Islami, Gjyqtar i EULEX-it**

**Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it**